
	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	<p>PRISHTINA</p> 
---	--	---

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-140799/22 dt. 20.06.2022, të pronarëve Nuhi, Isa, Abdurrahman dhe Sanije Sekiraqa nga Prishtina dhe investitorit “Nardi-Alko -Impex” Sh.p.k. me seli në Prishtinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “A-15” të tërësisë “A”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në rrugën “Abaz Ermenji” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 01.02.2023, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarëve Nuhi, Isa, Abdurrahman dhe Sanije Sekiraqa nga Prishtina, me investitor “Nardi-Alko -Impex” Sh.p.k. me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810822272, me përfaqësues Imer Ademi, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-140799/22 dt. 20.06.2022, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesës “3” me etazhitet B+S+P+4ET, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-33403 dt. 17.08.2016, dhe Vendimit për plotësim ndryshimim me numër 05 Nr. 351/05-152474/19 dt. 30.07.2019, në kuadër të bllokut urban “A-15” të tërësisë “A”, të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë konkretisht në parcelën kadastrale nr. 1570-0, ZK Matiçan.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugët “Abaz Ermenji” ku ka dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 10, 12, 14 dhe 16 në Prishtinë, dhe të njëjtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njërive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronarët Nuhi, Isa, Abdurrahman dhe Sanije Sekiraqa nga Prishtina dhe investitori "Nardi-Alko -Impex" Sh.p.k. me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810822272, me përfaqësues Imer Ademi, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-140799/22 dt. 20.06.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesa "3" me etazhitet B+S+P+4ET, të ndërtuar në kuadër të bllokut urban "A-15" të tërësisë "A", të Planit Rregullues "Mati 1", në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1570-0, ZK Matiçan, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore Ndërtimore 05 Nr. 351-33403 dt. 17.08.2016, dhe Vendimit për plotësim ndryshimin me numër 05 Nr. 351/05-152474/19 dt. 30.07.2019, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë, me referencë 09 Nr. 391/02-90418/22 dt. 10.06.2022, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimin mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografii gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të ndërtesës, nga udhëheqësi i punishtes Besian Sinani; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Arbër Sadiki; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Arbon Prekadini; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Kujtesa Mashkulli-Ahmeti; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Nazmi Bajrami; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Halil Demolli; Raportin e përfundimit të punëve për mbrojtje nga zjarri, nga Nazmi Bajrami, Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licencuar Ibrahim Jonuzi me nr. të licencës 105;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e

certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shumë banesore me afarizëm.


Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI


Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuessve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-140799/22 DT. 01.02.2023**

Zyrtari,
Berim Osmanaj



U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



Drejtori,
Arber Sadiki



